

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Pastrim ,krasitje pemësh Lumi Devoll”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):77340000-5

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventivdhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”i ndryshuar.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike,argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerivepër këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, të ndryshuar.

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,249,924 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) lekë pa tvsh

1,499,909 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntë) lekë me tvsh

Preventivii perllogaritur per kete procedure eshte hartuar sipas VKM Nr 216 date 13.04.2023,në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2026 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 *“Për prokurimin publik”*,i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c ,i ndryshuar dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*,i ndryshuar,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq** ka hartuarprocesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kritereve te pergjithshme te Pranim / Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit per vitet 2023-2024-2025 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe te shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 3 ,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

” Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2026 ,pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrisë Tregtare dhe për vitin 2026(këstet e maturuara të vitit 2026) sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse,

bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se ka :

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë **pese viteve** të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marre se bashku gjatë pese viteve të fundit të jete **jo më e vogël se fondi limit i kontratës** që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin publik** Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, **vërtetime**, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me **fatura tatimore** të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

- a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NP 12 -A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

(Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persiper të realizojë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 12	<i>Punime të inxhinierisë së mjedisit</i>	Pastrim , prerje e sistemim pemësh	A	

NP-12A (Punime te inxhinierise se mjedisit)

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ” *Pastrim ,Krasitje Pemësh Lumi Devoll* “ është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar me këtë kategori license.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, nenin39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar,, si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, “për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate (nga Administratori ishoqërisë), Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te perfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet te jete :

- **Inxhinier Pyjesh (1)**

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. Njësia e Prokurimit është bazuar nënenin 77, tëligjit nr. 162,”Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 c.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Inxhiner Pyjesh është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve. Ai është i nevojshëm sepse identifikon bimësinë që mund të pritet ,kontrollon krastitjen dhe prerjen,organizon sistemin e materialit drusor ,siguron që prerjet të behen sipas rregullave mjedisore,mbikqyr ekipet me motokosa dhe sharra si dhe është përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e gjithë procesit të punës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas formularit të vetdeklarimit se ka një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikate trajnimi për *”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhëne nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj
Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë,ky kusht quhet i plotësuar edhe kur vetem 1 operator ekonomik paraqit dokumentat per punonjesin te pajisur me certifikate trajnimi për ”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin Nr.10237 datë 10.02.2020”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe ligjit nr.16/ 2014 I ndryshuar*

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në formularin e vetdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht **17** punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Manovrator** (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

Kur mjetet janë në pronësi

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor

Kur mjetet janë me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me manovratorin(i cili duhet te kete Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor) deri ne perfundimin e afateve të kontrates.

- **Sharrëxhi** (4)
- **Punetor krastitje** (6)

“Për punonjësit e mësipërm në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që

të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);
ose
Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- Punetore të thjeshtë (4)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/entiteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;

- Punonjës shofer kamioni (1)

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit autoriteti kontraktor I kërkon ofertuesit I kualifikuar I pari, dorëzimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertës të dorëzuar në mënyrë elektronike si më poshtë:

Kur mjetet janë në pronësi

1. kontrata e punës (e vlefshme);
2. leje drejtimi kategoria C

Kur mjetet janë me qera

1. Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqesë kontratë pune me shofer kamioni (i cili duhet të ketë leje drejtimi kategoria C) deri në përfundimin e afateve të kontratës.

-Punonjës shofer kamioncine (1)

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit autoriteti kontraktor I kërkon ofertuesit I kualifikuar I pari, dorëzimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertës të dorëzuar në mënyrë elektronike si më poshtë:

Kur mjetet janë në pronësi

1. kontrata e punës (e vlefshme);
2. leje drejtimi kategoria B

Kur mjetet janë me qera

1. *Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me shofer kamioni(i cili duhet te kete leje drejtimi kategoria B)deri ne perfundimin e afateve te kontrates.*

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetdeklarimit se ka një punësim mesatar i të paktën 18 (tetembedhete) punonjësish se bashku me stafin inxhinierik për muajin e fundit.

Kur operatori ekonomik i disponon mjetet me qira, do te paraqese deklarate per punonjestit (Punonjës shofer kamioncine (1), Punonjës shofer kamioni (1), Manovrator (1)), qe ne rastin e shpalljes fitues, punonjesit jane te siguruar ne Administrata Tatimore.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

Dhe

Listpagesat e konfirmuar (*me firme dhe vule*) nga Administrata Tatimore te punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e ketyre kriterëve per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne nje kohe te shkurter i cili kerkon fuqi punetore te shtuar dhe me mjetet e kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

- Manovrator (1)

Është kërkuar 1 manovrator për drejtimin e makinerive të rënda ,të fadromës

- Sharrëxhi (4)

Janë kërkuar 4 sharrëxhi bazuar në zerat e punimeve në preventiv, për prerje e sitemim pemësh ϕ 10-20cm

- Punëtorë për krastitje (6)

Janë kërkuar 2 puntorë krastitje bimesh bazuar në zerat e punimeve në preventiv, për prerje bime të vogla ϕ -10 cm

- Punëtore të thjeshtë (4)

Janë kërkuar 3 puntorë bazuar në gjithë zerat e preventivit që do ndihmojnë për të gjitha punët e nevojshme gjatë prerjes,krastitjes,grumbullimit të materialeve dhe pastrimit të zonës ku do punohet.

shofer kamioni (1)

Është kërkuar 1 shofer kamioni për drejtimin e kamionit vetshkarkues

- Shofer kamionçine (1)

Është kërkuar 1 shofer për drejtimin e kamioncinës

OBJEKTI: PASTRIM ,KRASITJE PEMESH LUMI DEVOLL

Nr.	Nr. AN	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	Njësia	Sasia	OP/NJ	OP/GJITH
I		<i>Pastrim ,Krasitje Pemesh Lumi Devoll</i>				
1	3.2	Prerje bime te vogla φ-10 cm	M2	19680	0.08	1574.4
2	3.3	Prerje e sitemim pemesh φ 10-20cm	cope	2850	0.4	1140
		Shuma				2714.4

ZBERTHIMI I PREVENTIVIT:

- Nga zberthimi i preventivit orët e punës për cdo zë punimi rezultojnë 2714.4 orë
- Orët në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore $1769: 8 = 339.3$
kemi 340 punëtorë për një ditë pune
- 340 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 15.4 punëtorë për një muaj punë.
- Pra për 1 muaj duhen 15 punëtorë
- Gjithashtu duhen edhe 1 shofer kamioni për të marrë në ngarkim 1 kamion vetshkarkues dhe 1 shofer për kamioncinën

2.3.7 Shoqeria duhet të paraqesë Çertifikata ISO ose ekuivalente te vlefshme:

1. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit).
2. ISO 45001-2023 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Sharrë profesionale	4 copë	Pronësi ose me qera
2. Motokosa	2 copë	Pronësi ose me qera
3. Fadromë	1 copë	Pronësi ose me qera
4. Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
5. Kamioncinë kapacitet mbajtës 1.5- 2 ton	1 copë	Pronësi ose me qera

(Shenim per kapacitetin mbajtes se mjeteve te kerkuara per realizimin e punimeve. Kapaciteti mbajtes i mjeteve sipas lejes se qarkullimit do llogaritet nga diferenca midis Mases maksimale me ngarkese te plote te lejuar ne Shqiperi dhe Mases se mjetit bosh.)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:
1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
 3. Police sigurimi (e vlefshme)

4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme
5. Certificate per lejetransportiteleshuarnga Bashkia

dhe permjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj i cili te jete i vlefshem gjate periudhes se kryerjes se punimeve.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]
6. Certificate per lejetransportiteleshuarnga Bashkia

Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certificate e transportit te mallrave) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

permjetet me qera :

- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

c) Deklarate nga Operatori ekonomik per makineritë e mësipërme te cilat nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata.

1- Sharrë profesionale 4 copë

Janë kërkuar 2 sharra bazuar ne zerat e preventivit për prerje e sistemim pemësh ϕ 10-20 cm

2- Moto kosa 2 copë

Janë kërkuar 2 motokosa bazuar në zërat e preventivit për prerje bimë të vogla ϕ -10 cm

3- Fadromë 1 copë

Është kërkuar 1 fadromë bazuar në objektn e prokurimti që është pastrim,krastitje pemësh lumi Devoll,duhet për pastrimin e pjesëve anësore të lumit

4- Kamion vetshkarkues kapacitet mbajtës 5-10 ton 1 copë

Është kërkuar 1 kamion vetshkarkues për transportin e materialeve të ndryshme si mbeturina,degët,drurët që të do priten si dhe mbetjet e tjera

5- Kamioncinë kapacitet mbajtës 1.5- 2 ton 1 copë

Është kërkuar 1 kamionçinë për transportin e materialeve dhe punëtorëve në vendin e punës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoare, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).